



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2023:206608

Datë: 28.03.2024

Numri i dokumentit: 05520603

*P.nr.1062/2023*

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NE PRIZREN – Departamenti i pergjithshem Penal,** gjyqtari i vetem gjykues Fatmir Krasniqi me sekretaren juridike Fatime Bajraktari, në lëndën penale kundër të akuzuarit **Sh.T.**, nga Prizreni, me mbrojtësin e tij **av.E.H.**, nga Prizreni, për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KP-së, sipas aktakuzes të Prokurorisë Themelore të shtetit në Prizren PP.nr.1765-2/23, të datës 16.10.23, pas mbajtjes së seancës fillestare gjyqesore publike, në prezencën e Prokurorit Themelore të shtetit në Prizren Besim Susuri, të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij avokat, me datë **27.03.2024**, morri dhe shpalli publikisht këtë:

## AKT GJYKIM

I akuzuari **Sh.T.**, nga i ati ....., dhe e ëma ....., e vajzërisë ....., i lindur më dt. ....në Prizren, ku edhe tani jeton në rr. ....pnr, ka të kryer shkollën e mesme, punëtor, i martuar, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me nr.pers. ....,

## ESHTË FAJTOR

Se me datën 28.09.2023, rreth orës 08:30 min., në Prizren, në Rr. “ Aleks Buda”, p.n, mban në pronësi, kontrollon ose posedon armë në shkelje të ligjit të zbatueshëm lidhur me armët e tilla në mënyrë të paautorizuar përkatësisht pa leje valide të organit kompetent, në atë mënyrë që gjatë kontrollit të ushtruar nga policia në shtëpinë e të pandehurit gjejnë 2 (dy) pushkë automatike me nr. serik 088003-89 dhe 0351-79, si dhe 1 (një) karikator i pushkës automatike AK47, të fshehura në një orman, ku të cilat janë sekuestruar të gjitha si dëshmi.

**Me këto veprime ka kryer veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 paragrafi 1 të KP-së.**

Gjykata në bazë të nenit 4, 7, 17, 21, 38, 39, 40, 43, 69, 70, 71, 72 të KP-se, dhe neni 366 par.1 të KP-es e nenit 364 të KPPK-es, të akuzuarit i shqipton:

## D E N I M M E G J O B E

Ne lartesi prej **2.000,00 /dymije/ eurove**, te cilen shume te denimit eshte i obliguar qe te paguaje ne afat prej 15 diteve, pas plotefuqishmerise te ketij aktgjykimi, denimin me gjobe do ta paguaje ne 4 kiste, nese denimi me gjobe nuk ekzekutohet as me detyrim i njejti do te zevendesohet me denim burgu duke llogaritur per çdo **20** euro nje dite burg, rrespektivisht denim burgimi prej 100 diteve,

Ne kuptim te nenit 366 par.3 te KP-es, te akuzuarit gjykata i konfiskon – merr dy pushke automatike me nr.serik 088003-89, si dhe 0351-79, dhe 1 karikator te pushkes automatike AK-47,

I akuzuari obligohet që ti paguajne shpenzimet e procedurës penale sipas llogarise se gjykates, ndërkaq në emër të paushallit gjygjësor shumën prej **20 euro**, si dhe ne emer te kompenzimit per viktimat e krimit shumen prej **20 eurove**, të gjitha këto ne afat prej 15 ditësh, prej ditës së plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nen kerccnim te ekzekutimit te dhunshem.

## A r s y e t i m

Prokuroria Themelore ne Prizren, kesaj gjykate i ka parashtruar aktakuzen me nr. PP.nr.1765-2/2023 te dt.16.10.2023, kunder te akuzuarit Sh.T., nga Prizreni, per shkak te vepres penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 parag. 1 të KP-së.

Gjykata ne shqyrtim gjyqesor ka vertetuar gjendjen e ketille faktike nga pranimi i fajesise nga ana e te akuzuarit i cili vullnetarisht e ka pranuar fajsin, per shkak te se ciles gjykata fare nuk ka administruar provat. Sipas detyres zyrtare gjykata nuk gjeti se ekziston ndonje prove e pa pranueshme, gjithashtu gjykata ne teresi ka vertetuar se i akuzuari ka kuptuar natyren dhe pasojat e pranimi te fajit per vepren penale e cila i vihet ne bare, e qe pranimi i fajit eshte bere ne menyre vullnetare dhe pa kushtezime, duke u mbeshtetur ne fakte dhe prova materiale te cilat jane paraqitur ne aktakuze, per te cilat i akuzuari ka qene i njoftuar me te gjitha provat materiale. Gjykata ka ardhë ne perfundim, se pranimi i fajesise nga ana e te akuzuarit eshte bere ne pajtim me nenin 242 par.1 e 2 nenpar.2.1, 2.2 2.3, 2.4 te KPPK-se, dhe faktet qe permban aktakuza, ne veprimet e te akuzuarit formohen te gjitha elementet e vepres penale, mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 parag. 1 të KP-së, dhe per kete gjykata te akuzuarin e shpalli fajtor dhe i shqiptoi denimin me gjobe si te merituar, paraprakisht duke e vertetuar pergjegjesine e tije penalo-juridike.

Me rastin e caktimit te denimit ndaj te akuzuarit gjykata vleresoi te gjitha rrethanat ne kuptim te nenit 69 te KPK-se te cilat ndikojne ne llojin dhe lartesine e denimit, duke mos e gjetur rrethanat posaqerisht renduese, e si rrethane lehtesuese eshte marre pranimi i fajesise nga ana e te akuzuarit, pranimin e fajesise e ka bere vullnetshem, pa presion e pa ndikim nga jashte, e ne kuptim te dispozitave te nenit 70, 71 e 72, i akuzuari ka bashkepunuar me gjykatën, bashkepunimi i tije ka qene vullnetar ne hetimin dhe ndjekjen penale edhe te kryeresve te tjer te veprave penale, ka pranuar fajesin si dhe ka shprehur keqardhje per vepren e kryer penale, sjellja korrekte pas kryerjes se vepres penale, pendimi i thelle i tije, dhe premtion se deri me sot as qe e ka perdorur, e as qe do te perdor armen asnjeher ne te ardhmen, gjer me tani te pa

gjykuar, çka nenkupton se nuk kane ardhur ndesh me rregullat pozitive, relativisht i ri ne moshe, andaj gjykata ia shqiptoi denimin me gjobe te akuzuarit, sepse konsideron se me shqiptimin e denimit do te arrihet qellimi i denimit, njeherit krahas denimit kryesor, gjykata te njejtit ne kuptim te nenit 366 par.3 te KP-es i konfiskoi – dy pushke automatike dhe nje karikator si me larte shenuar, objekt i kryerjes se vepres penale, sepse konsideron se me me kete mase sanksionuese do te arrihet qellimi i denimit, duke menduar se denimi i shqiptuar i pergjigjet shkalles se pergjegjesise se tije dhe me kete denim do te arrihet qellimi i denimit qe ne te ardhmen te jete me i kujdesshem dhe do te permbahet nga veprimet e tilla.

Vendimi mbi paushallin gjyqesor gjykata e bazoi ne kuptim te nenit 450, e 451 te KPPK-se.

Ne kuptim te nenit 366 par.3 te KP-es, lidhur me konfiskimin u vendos si ne dispozitiv te ketij aktgjykimi.

Si u cek edhe më lartë u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**  
**Departamenti i pergjithshem penal**  
**P.nr.1062/2023 të datës 27.03.2024**

**Sekretare Juridike**  
**Fatime Bajraktari**

**Gjyqtari**  
**Fatmir Krasniqi**

**UDHËZIM JURIDIK:** Kunder ketij aktgjykimi pala e pakenaqr ka te drejte ankese ne afat prej 30 diteve nga dita e marrjes se te njejtës, Gjykates se Apelit ne Prishtine nepermjet te kesaj gjykate.

Numri i lëndës: 2023:206608  
Datë: 28.03.2024  
Numri i dokumentit: 05520603